



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 Janar 2013
Nr. ref.: RK344/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI79/10

Parashtruesi

Izet Zejnullahu

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
Rev. nr. 93/2010, të 30 qershorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare, dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Izet Zejnullahu, me vendbanim në Vushtrri. Ai përfaqësohet nga avokati Zait Xhemajli, rr. "Meto Bajraktari" nr. 30, Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 93/2010, i 30 qershorit 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi e konteston vendimin e Shërbimit Policor të Kosovës në Prishtinë për shkëputjen e kontratës së tij të punës si zyrtar policor.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

5. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 26 gusht 2010. Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin kërkesës më 30 gusht 2010.
6. Më 1 shtator 2010, Kryetari i Gjykatës e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe, po të njëjtën datë, Kryetari e caktoi edhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
7. Gjykata Kushtetuese i njoftoi Gjykatën Supreme të Kosovës dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës për parashtrimin e kërkesës.
8. Mistria e Punëve të Brendshme iu përgjigj këtij njoftimi më 4 prill 2011.
9. Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues më 6 mars 2012 dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Parashtruesi ishte i punësuar në Policinë e Kosovës, por u përjashtua nga Policia në vitin 2008, në përputhje me vendimin e Komisionit disiplinor, të 28 janarit 2008, dhe vendimin e Bordit të ankesave të Ministrisë së Punëve të Brendshme - Policisë së Kosovës, të 23 marsit 2008.
11. Arsyet për përjashtimin e tij nga puna ishin se kur parashtruesi konkurroi për punësim në Policinë e Kosovës, ai theksoi në formularin e kërkesës së tij se kundër tij nuk ishte iniciuar asnjë procedurë për veprime të paligjshme. Megjithatë, informacioni i ofruar nuk ishte i saktë. Më 26 tetor 2002, parashtruesi u pyet në formularin për punësim, "*... a jeni arrestuar më parë apo a keni qenë subjekt i ndonjë procedure hetimore?*" Parashtruesi iu përgjigj kësaj pyetjeje me "*Jo*".
12. Më pas u kuptua që parashtruesi kishte qenë, në të vërtetë, i arrestuar në Republikën Federale të Gjermanisë për një vepër të rëndë penale të kryer në Manhajm, Gjermani, gjatë vitit 1998-1999. Ai hetim përcaktoi që parashtruesi kishte kaluar një ditë në burg pas arrestimit.
13. Parashtruesi e kontestoi vendimin për përjashtimin e tij nga Policia në Gjykatën Komunale dhe në Gjykatën e Qarkut, dhe ishte i suksesshëm. Megjithatë, Gjykata Supreme, në Aktgjykimin, Rev. nr. 93/2010, të 30 qershorit 2010, theksoi se paraqitja e rreme e rrethanave të dënimit të tij ishte arsyetim për përjashtimin e tij nga puna.

Pretendimet e parashtruesit

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Gjykata Supreme ka shkelur nenin 21, paragrafin 1 (Parimet e Përgjithshme); nenin 31, paragrafët 2 dhe 3 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm); nenin 49, paragrafin 1 (E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit); nenin 102, paragrafin 2 (Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor); dhe nenin 104, paragrafin 1 (Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve), të Kushtetutës.
15. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që Gjykata Supreme e ka shkelur nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (E drejta për një proces të rregullt).
16. Parashtruesi kërkon që Gjykata Kushtetuese ta caktojë masën e përkohshme.

Përgjigja e palës kundërshtare

17. Ministria e Punëve të Brendshme iu përgjigj Gjykatës nëpërmjet letrës së 4 prillit 2011, duke ripohuar obligimin e zyrtarëve policorë për t'i respektuar rregullat policore, në njërën prej të cilave thuhet: *"Parashtruesit e kërkesës dhe punonjësit duhet të jenë të sigurtë dhe gjithnjë ta thonë apo shkruajnë të vërtetën lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shërbimin zyrtar, duke përfshirë datën kur e parashtrojnë kërkesën për shërbim, pa marrë parasysh a janë nën betim apo jo"*.

Vlerësimi i pranueshmërisë të kërkesës

18. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
19. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të 23 qershorit 2010, ish-punëtorët e Korporatës Energjetike të Kosovës kundër 49 aktgjykimeve individuale të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, para. 66 dhe 67).
20. Pas shqyrtimit të procedurave në këto gjykata si tërësi, Gjykata Kushtetuese nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
21. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të tij sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmëri të kërkesës, Nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
22. Pasi parashtruesi i kërkesës vetëm konteston nëse Gjykata Supreme e zbatoi ligjin e duhur dhe nxori konkluzion të duhur faktik, duket që parashtruesi i kërkesës thjesht kërkon që kjo Gjykatë ta anulojë vendimin ligjor të Gjykatës Supreme. Prandaj, kjo kërkesë është qartazi e pabazuar në lidhje me shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese apo të drejtave të njeriut dhe, si rrjedhojë, është e papranueshme.

Vlerësimi i aspekteve juridike kryesore të kërkesës

23. Pasi kërkesa është e papranueshme, nuk ka bazë juridike për kërkesën e parashtruesit.
24. Pasi kërkesa është e papranueshme dhe pasi parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë për shkelje kushtetuese nga e cila do të pësonte dëme të riparueshme, si shpërblimi monetar nga punëdhënësi i tij i mëparshëm për shkëputje të paligjshme të kontratës, nuk ekziston asnjë bazë e vlefshme për caktimin e masës së përkohshme.
25. Parashtruesi nuk ka ofruar prova apo argumente për ta bazuar caktimin e masës së përkohshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 6 mars 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme,
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese




Prof. dr. Enver Hasani